


Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Tetor, 2018

Tiranë, më 08 Nëntor 2018: Indeksi i Çmimeve të Konsumit në muajin Tetor 2018, arriti 105,0 kundrejt muajit Dhjetor 2015.


Ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit në muajin Tetor 2018 është 1,9 %. Edhe një vit më parë ky ndryshim ishte 1,9 %. Ndryshimi mujor i indeksit të çmimeve të konsumit në muajin Tetor 2018, krahasuar me Shtator 2018, është -0,2 %.

Fig. 1 Ndryshimet vjetore të Indeksit të çmimeve të konsumit (%)



Ndikimi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të indeksit të çmimeve të konsumit. Rritja vjetore e çmimeve në muajin Tetor është ndikuar kryesisht nga grupet “Ushqime dhe pije joalkoolike” dhe “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me nga +0,70 pikë përqindje secili. Çmimet e grupit “Transporti” kanë kontribuar me +0,26 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Argëtim dhe kulturë” kanë kontribuar me +0,09 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Pije alkoolike dhe duhan” kanë kontribuar me +0,07 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Hotele, kafene dhe restorante” kanë kontribuar me +0,04 pikë përqindje. Çmimet e grupeve “Komunikimi” dhe “Shërbimi arsimor” kanë kontribuar me +0,02 pikë përqindje secili. Çmimet e grupeve “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mobilime” dhe “Mallra dhe shërbime të ndryshme” kanë kontribuar me +0,01 pikë përqindje secili. Çmimet e grupeve “Veshje dhe këpucë” dhe “Shëndeti” kanë kontribuar respektivisht me -0,02 dhe -0,01 pikë përqindje.

Fig.2 Ndikimi i grupeve në ndryshimin vjetor



Ndryshimet vjetore të grupeve kryesore: Krahasuar me muajin Tetor 2017, rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin “Transporti” me 4,3 %, pasuar nga grupet “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me 3,4 %, “Argëtim dhe kulturë” me 3,2 %, “Ushqime dhe pije joalkoolike” dhe “Pije alkoolike dhe duhan” me 1,8 % secili, “Hotele, kafene dhe restorante” me 1,0 %, “Shërbimi arsimor” me 0,8 % “Komunikimi” me 0,7 %, etj. Nga ana tjetër çmimet e grupit “Shëndeti” u ulën me 0,4 % pasuar nga grupi “Veshje dhe këpucë” me 0,3 %. Brenda grupit të ushqimeve çmimet e nëngrupit “zarzavate përfshirë patatet” u rritën me 11,5 %, pasuar nga nëngrupet “vajra dhe yndyrna” me 2,4 %, “qumësht, djathë dhe vezë” me 1,4 %, etj. Nga ana tjetër çmimet e nëngrupit “sheqer, reçelna e ëmbëlsira” u ulën me 2,1 %, pasuar nga “peshk” me 0,3 %, etj.

Ndryshimet mujore të grupeve kryesore: Krahasuar me muajin Shtator 2018, grupet “Ushqime dhe pije joalkoolike” dhe “Pije alkoolike dhe duhan” shënuan një ulje prej 1,0 % secili. Ndërsa, grupi “Transporti” u rrit me 0,8 %, pasuar nga “Veshje dhe këpucë” me 0,7 %, “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” dhe “Shërbimi arsimor” me 0,6 % secili, “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mobilime” me 0,2 %.

Tab. 1 Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Dhjetor 2015=100

Kodi	Grupet	Peshat	10-17	11-17	12-17	01-18	02-18	03-18	04-18	05-18	06-18	07-18	08-18	09-18	10-18
	Gjithsej	100	103,1	103,0	104,0	105,6	106,4	106,7	106,2	104,9	104,9	104,6	105,0	105,2	105,0
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	38,6	106,5	105,7	107,5	110,8	113,1	114,1	112,5	109,2	108,8	108,2	109,1	109,5	108,4
2	Pije alkoolike dhe duhan	3,5	101,5	101,7	101,8	102,9	103,0	103,6	103,6	103,3	103,4	103,4	103,4	103,3	103,4
3	Veshje dhe këpucë	4,1	99,9	100,2	101,5	101,0	100,4	99,5	99,3	98,5	99,0	98,5	98,4	98,9	99,6
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	20,9	101,6	102,0	103,1	104,4	104,4	104,0	104,1	104,1	104,3	104,2	104,3	104,4	105,0
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	6,1	99,5	99,7	100,2	100,1	100,3	100,2	99,9	99,9	99,7	99,2	99,3	99,5	99,6
6	Shëndeti	3,0	100,0	100,4	100,3	100,3	100,3	100,3	100,3	100,4	99,9	99,6	99,6	99,6	99,6
7	Transporti	6,0	100,0	101,3	101,2	101,2	101,1	101,2	101,4	101,8	102,4	103,0	103,3	103,5	104,3
8	Komunikimi	2,8	100,4	100,7	100,8	100,8	101,2	101,3	101,1	101,1	101,1	101,1	101,1	101,1	101,1
9	Argëtim dhe kulturë	2,6	103,3	101,8	102,3	102,4	102,8	103,9	105,6	105,8	105,8	105,2	105,7	107,8	106,7
10	Shërbimi arsimor	3,1	101,3	101,3	101,3	101,3	101,3	101,3	101,3	101,3	101,3	101,3	101,3	101,4	102,0
11	Hotele, kafene dhe restorante	3,8	100,1	100,2	100,6	100,7	100,8	100,9	101,0	101,0	101,0	101,2	101,2	101,1	101,2
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	5,5	103,4	103,4	103,5	103,6	103,6	103,7	103,8	103,7	103,7	103,6	103,6	103,6	103,5

Tab. 2 Ndryshimet vjetore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit

%

Kodi	Grupet	10-17/10-16	11-17/11-16	12-17/12-16	01-18/01-17	02-18/02-17	03-18/03-17	04-18/04-17	05-18/05-17	06-18/06-17	07-18/07-17	08-18/08-17	09-18/09-17	10-18/10-17
	Gjithsej	1,9	1,7	1,8	1,7	2,1	2,0	2,1	2,1	2,4	2,3	2,2	2,1	1,9
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	4,0	3,7	2,8	2,2	2,7	3,1	3,1	2,8	3,2	3,0	2,8	2,6	1,8
2	Pije alkoolike dhe duhan	0,4	0,9	0,5	1,5	1,6	1,9	1,7	1,6	1,6	1,7	1,8	1,7	1,8
3	Veshje dhe këpucë	-0,4	-0,4	0,6	1,1	2,9	1,8	3,4	2,2	3,3	2,3	2,4	0,6	-0,3
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	1,1	0,6	2,2	3,3	3,1	2,2	2,5	2,7	2,9	2,8	2,8	2,8	3,4
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	-0,2	-0,5	0,0	-0,2	0,2	0,2	0,0	0,0	-0,1	-0,3	-0,2	0,0	0,1
6	Shëndeti	0,0	0,2	0,1	0,1	0,1	0,0	0,2	0,2	-0,2	-0,5	-0,4	-0,4	-0,4
7	Transporti	0,4	1,9	2,1	1,8	2,3	1,3	1,0	2,1	3,1	3,2	3,0	3,2	4,3
8	Komunikimi	0,0	0,0	0,2	0,6	1,0	1,0	0,6	0,6	0,6	0,6	0,6	0,7	0,7
9	Argëtim dhe kulturë	2,1	0,8	-0,1	-0,8	-0,2	0,5	0,8	3,5	4,2	4,6	5,3	5,2	3,2
10	Shërbimi arsimor	0,9	0,5	0,6	0,6	0,6	0,6	0,6	0,6	0,6	0,6	0,6	0,5	0,8
11	Hotele, kafene dhe restorante	0,0	0,2	0,5	0,7	0,7	0,7	0,9	0,9	0,9	1,1	1,1	1,0	1,0
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	0,2	0,3	0,2	0,3	0,4	0,2	0,5	0,3	0,3	0,2	0,2	0,1	0,1

Tab. 3 Ndryshimet mujore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit

%

Kodi	Grupet	10-17	11-17	12-17	01-18	02-18	03-18	04-18	05-18	06-18	07-18	08-18	09-18	10-18
	Gjithsej	0,04	-0,1	1,0	1,5	0,8	0,3	-0,5	-1,2	-0,1	-0,3	0,4	0,2	-0,2
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	-0,1	-0,8	1,8	3,1	2,0	0,9	-1,4	-3,0	-0,3	-0,5	0,8	0,3	-1,0
2	Pije alkoolike dhe duhan	0,0	0,2	0,1	1,1	0,1	0,6	0,0	-0,3	0,1	0,0	0,0	-0,1	0,0
3	Veshje dhe këpucë	1,6	0,3	1,3	-0,5	-0,6	-0,9	-0,2	-0,8	0,5	-0,5	-0,2	0,6	0,7
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	0,1	0,4	1,0	1,3	0,0	-0,4	0,1	0,0	0,1	0,0	0,0	0,1	0,6
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	0,1	0,2	0,5	-0,1	0,2	-0,1	-0,2	-0,1	-0,1	-0,6	0,2	0,1	0,2
6	Shëndeti	0,0	0,4	-0,1	0,0	0,0	0,0	0,0	0,1	-0,5	-0,3	0,0	0,0	0,0
7	Transporti	-0,3	1,3	-0,1	0,0	-0,1	0,1	0,2	0,4	0,6	0,5	0,3	0,2	0,8
8	Komunikimi	0,0	0,2	0,2	0,0	0,4	0,0	-0,2	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
9	Argëtim dhe kulturë	0,8	-1,5	0,5	0,2	0,4	1,0	1,7	0,2	0,0	-0,5	0,4	2,0	-1,0
10	Shërbimi arsimor	0,3	0,0	0,1	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,1	0,6
11	Hotele, kafene dhe restorante	0,0	0,0	0,4	0,2	0,1	0,0	0,1	0,0	0,0	0,1	0,1	-0,1	0,0
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	0,0	0,0	0,1	0,0	0,0	0,1	0,2	-0,2	0,0	-0,1	0,0	-0,1	0,0

SHPJEGIME METODOLOGJIKE

- Ndryshime metodologjike

Në muajin Janar të çdo viti Indeksi i Çmimeve të Konsumit shoqërohet me disa ndryshime metodologjike sipas metodologjise ndërkombëtare të llogaritjes së këtij treguesi, të cilat konsistojnë në:

- Përditësimin e peshave: Peshat e mallrave dhe shërbimeve janë ndryshuar duke u bazuar në shpenzimet mesatare të Anketës së Buxhetit të Familjeve 2016.
- Përditësimin e listës së mallrave dhe shërbimeve: Kjo listë nuk ka ndryshime me vitin e kaluar, shporta përbëhet nga 332 produkte dhe shërbime.
- Përditësimin e listës së njësive tregtare ku mbliidhen çmimet.

Përkufizime

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) është matësi zyrtar i inflacionit në Shqipëri. Indeksi mat ndryshimet relative të çmimeve të mallrave dhe shërbimeve të përdorura nga familjet për konsum vetjak dhe llogaritet duke përdorur strukturën e konsumit final të familjeve shqiptare. Burimi kryesor i informacionit për shpenzimet është Anketa e Buxhetit të Familjeve.

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve midis muajit korrent me të njëjtin muaj të vitit të mëparshëm. Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve korente në nivelin e çmimeve por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të cilitdo muaj.

Ndryshimi mujor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të muajit korrent me muajin e mëparshëm. Ky tregues është i ndjeshëm nga efektet sezonale.

Ndryshimi mesatar 12 mujor mat ndryshimin e indeksit mesatar të konsumit në 12 muajt e fundit me indeksin mesatar të 12 muajve të mëparshëm.